


## Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ) të Kosovës,

Ky raport paraqet bilancin tregtar të mallrave për periudhën 2021–2025, duke vënë në pah një rritje të deficitit tregtar që ka arritur në mbi 6 miliardë Euro. Raporti paraqet strukturën e importeve dhe eksporteve në përqindje (%) sipas katitujve. Përmes të dhënave krahasimore, identifikohen sektorë me potencial të lartë për zëvendësimin e importit, rritjen e exportin si bujqësia, industria e plastikës dhe përpunimi i drurit. Raporti rekomandon orientimin drejt një ekonomie prodhuese duke shfrytëzuar burimet natyrore dhe kapitalin njerëzor, po ashtu rekomandon disa masa mbështetëse institucionale, si përmirësimin e infrastrukturës, çertifikimin e produkteve vendore sipas standardeve ndërkombëtare, te cilat do të ndihmonin konkurrueshmërisë dhe përmirësimin të qëndrueshëm të bilancit tregtar.

### 1. Bilanci mallërave dhe dinamika e Import-Eksportit (2021–2025)

Sipas të dhënave mujore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për vitin 2025, deficitin tregtar të mallrave ka shënuar një rritje prej 13.3% krahasuar me vitin 2024, duke arritur në -6,106.3 milionë Euro në vitin 2025, nga -5,388.6 milionë Euro sa ishte në vitin 2024. Mbulueshmëria e importit nga eksporti ka rënë në 13.4%.


Figura 1. Bilanci tregtar i mallrave sipas viteve në milion Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), <https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/>

Në periudhën Janar Dhjetor 2025, Importi i mallrave arrinë në 7,048.3 milionë Euro apo 11.3% më shumë se periudha e njëjtë e vitit paraprak, derisa Exporti ka një trend në rënie duke regjistruar vlerat prej 942.1 milionë Euro, apo rreth 0.2% më pakë se periudha e njëjtë e vitit 2024.

Figura 2. Export/Importi i Kosovës sipas viteve në milion Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK), <https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/>

## 2. Struktura e Importit-Exportit të mallrave sipas Kapitujve<sup>1</sup>

### 2.1. Importi i mallrave sipas kapitujve (analiza krahasimore e trendeve)

Të dhënat në vazhdim paraqesin strukturën e importeve të Kosovës, duke zbërthyer pjesëmarrjen në përqindje të secilit kapitull të mallrave sipas viteve. Te Tabela 1. analizohet ecuria vjetore sipas kategori të mallrave tregtar për periudhën 2021 – 2025.

Këto të dhëna nxjerrin në pah varësinë e lartë të ekonomisë vendore nga produktet energjetike, makineritë dhe mjetet e transportit. Analiza shërben si bazë për të identifikuar sektorët me potencial për zëvendësimin e importit dhe rritjen e prodhimit të brendshëm.

Tabela 1. Importi sipas Kapitujve (01 deri 99), strukturuar në % sipas viteve 2021 deri 2025

Importi sipas Kapitujve, struktura në %	2025	2024	2023	2022	2021
01 Kafshë të gjalla	1.4%	1.5%	1.5%	1.2%	1.1%
02 Mish dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit	2.2%	2.0%	1.8%	2.2%	1.8%
03 Peshku dhe kafshët guackore të nënujshme	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
04 Produkte bulmetore, vezët, mjalti	1.3%	1.4%	1.4%	1.4%	1.3%
05 Produkte me origjinë kafshore të papërfshira diku tjetër	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%

<sup>1</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), në baza mujore publikon të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit të mallrave sipas Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, në formatin për 99 Kapituj (01-99), për 21 Seksione kryesore (01-21) etj.

06 Pemët dhe bimët, rrënjët, lulet dhe gjethet zbukurorese	0.2%	0.2%	0.2%	0.1%	0.1%
07 Zarzavatet e ngrënshme dhe rrënjët e tuberat përkatëse	0.8%	0.8%	0.8%	0.6%	0.7%
08 Frutat dhe arrat e ngrënshme	1.2%	1.0%	1.0%	0.8%	0.9%
09 Kafe, çaj dhe erëza	0.9%	0.8%	0.7%	0.7%	0.7%
10 Drithërat	0.6%	0.7%	0.9%	1.0%	0.8%
11 Produkte të industrisë bluajtëse, mjalti, niseshte	0.2%	0.2%	0.2%	0.2%	0.2%
12 Farat vajore, bimët industriale apo medicinale, ushqim për kafshët	0.2%	0.2%	0.2%	0.2%	0.2%
13 Rreshrat dhe lëngje e ekstrakte të tjera vegjetale	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
14 Materiale vegjetale që përdoren për thurje	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
15 Vajra dhe dhjamra kafshore apo vegjetale	0.8%	0.8%	0.7%	1.1%	0.9%
16 Ushqimet e përgatitura prej mishi, peshku, molusqe, etj.	0.8%	0.8%	0.8%	0.8%	0.8%
17 Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij	0.7%	0.8%	0.9%	0.9%	0.8%
18 Kakao dhe përgatitje kakao	0.6%	0.7%	0.6%	0.6%	0.6%
19 Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit	2.0%	2.0%	2.0%	1.9%	1.9%
20 Përgatitjet prej zarzavateve, frutave, arrave, etj.	0.8%	0.9%	0.8%	0.7%	0.8%
21 Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	2.0%	2.1%	1.9%	1.9%	2.0%
22 Pijet, alkoolet dhe uthullat	2.2%	2.3%	2.4%	2.4%	2.5%
23 Mbetjet dhe kthimet nga industria ushqimore	0.6%	0.5%	0.6%	0.6%	0.6%
24 Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit	2.3%	2.2%	2.0%	1.9%	1.9%
25 Kripërat, sulfuret, oksidet, gëlqere dhe çimento	1.6%	1.5%	1.5%	1.3%	1.5%
26 Xeherorët, zgjyrat dhe hiri	0.0%	0.1%	0.0%	0.1%	0.2%
27 Lëndët djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet e distilimit të tyre	12.3%	12.4%	13.1%	17.1%	11.7%
28 Kimikatet inorganike, përbërjet organike	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
29 Kimikatet organike	0.2%	0.2%	0.3%	0.4%	0.4%
30 Produktet farmaceutike	2.7%	2.5%	1.9%	2.2%	2.4%
31 Plehëruesit	0.4%	0.4%	0.5%	0.6%	0.4%
32 Ekstraktet ngjyrosëse dhe tanike, stukot dhe mastiçet, bojrat	0.8%	0.9%	0.9%	0.9%	1.0%
33 Vajrat thelbësore dhe rrëshirat, përg. e parfu., kozmetikës, tualetit	1.4%	1.4%	1.3%	1.1%	1.2%
34 Sapuni, preparatet parëse, lubrifikues, qirinjtë	1.0%	1.1%	1.0%	0.9%	1.0%
35 Substancat albuminoide, enzimat	0.1%	0.1%	0.2%	0.2%	0.2%
36 Eksplozivët, produktet piroteknike, shkrepset	0.0%	0.1%	0.1%	0.1%	0.0%
37 Mallrat fotografike dhe kinematografike	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
38 Produkte të ndryshme kimike	0.7%	0.7%	0.7%	0.6%	0.7%
39 Plastika dhe artikuj prej tyre	4.6%	4.9%	5.1%	6.0%	6.4%
40 Gomë dhe artikuj të tij	0.8%	0.8%	0.8%	0.8%	0.8%
41 Lëkurët e papërpunuara dhe të përpunuara	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
42 Artikuj prej lëkure	0.3%	0.3%	0.3%	0.2%	0.2%
43 Gëzofët dhe qimet artificiale	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
44 Druri dhe artikuj prej druri, qymyri i drurit	1.9%	2.0%	2.0%	2.2%	2.2%
45 Tapa dhe artikuj prej tape	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
46 Prodhimet e kashtës, punimet në xunkth e në kallama	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
47 Brumi i drurit apo i materialeve të tjera fibroze celulozike	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
48 Letra dhe kartoni, artikuj të brumit të letrës dhe të kartonit	1.1%	1.2%	1.3%	1.4%	1.2%

49 Librat, revistat, pikturat dorëshkrimet, shtypshkrimet dhe projektet	0.1%	0.1%	0.2%	0.2%	0.1%
50 Mëndafsh	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
51 Leshi, qime kafshësh të holla	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
52 Pambuku	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
53 Fibra të tjera tekstile vegjetale	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
54 Filamentet e bëra nga njerëzit	0.3%	0.3%	0.2%	0.2%	0.2%
55 Fibrat themelore të bëra nga njerëzit	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.2%
56 Mbushjet shajak dhe pëlhura të paendura	0.2%	0.2%	0.3%	0.3%	0.3%
57 Qilimet dhe veshje të tjera të dyshemesë prej tekstili	0.3%	0.3%	0.2%	0.3%	0.3%
58 Pëlhurat speciale të endura, tantella, tapiceri, qëndismat	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
59 Pëlhura tekstile të ngopura, të veshura, të mbul. apo të laminu.	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
60 Pëlhura të thurura me një fije apo me shumë fije	0.2%	0.2%	0.3%	0.3%	0.4%
61 Artikuj të veshjes dhe rroba plotësuese, të thurura	1.5%	1.5%	1.5%	1.2%	1.3%
62 Artikuj të veshjes dhe plotësues të veshjes jo të thurura	2.2%	2.1%	2.0%	1.7%	1.7%
63 Artikuj të tjerë tekstile të ndërt., veshjet e përd., lecka mbetu.	0.4%	0.4%	0.4%	0.3%	0.4%
64 Veshjet e këmbëve	0.9%	1.0%	1.0%	0.9%	0.9%
65 Veshjet e kokës	0.0%	0.0%	0.1%	0.0%	0.0%
66 Çadrat e diellit, bastunet etj.	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
67 Puplat dhe pushi i përgatitur, lulet artificiale	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
68 Artikuj prej guri, allçie, çimento, mike, asbesti etj	0.5%	0.6%	0.5%	0.6%	0.6%
69 Produkte qeramike	1.4%	1.4%	1.5%	1.6%	1.8%
70 Qelqi dhe artikuj prej qelqi	1.0%	1.0%	1.1%	1.2%	1.1%
71 Perlat natyrale, gurët e çmuar, bizhuteritë, monedhat	0.4%	0.3%	0.4%	0.2%	0.1%
72 Giza dhe çeliku	4.7%	5.2%	5.5%	6.0%	6.2%
73 Artikuj prej gize dhe çeliku	1.7%	1.7%	1.8%	1.8%	2.2%
74 Bakri dhe artikuj prej bakri	0.3%	0.3%	0.3%	0.3%	0.4%
75 Nikeli dhe artikuj prej tij	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
76 Alumini dhe artikuj prej tij	1.6%	1.6%	1.5%	1.4%	1.3%
78 Plumbi dhe artikuj prej tij	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
79 Zinku dhe artikuj prej tij	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
80 Kallaji dhe artikuj prej tij	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
81 Metale të tjera bazë	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
82 Veglat e punës, pajisjet e punës, takëmet e ngrënies etj	0.3%	0.3%	0.2%	0.2%	0.3%
83 Artikuj të ndryshëm prej metali bazë	0.7%	0.7%	0.7%	0.7%	0.7%
84 Reaktorët nuklearë, bolierët, makineritë e pajisjet mekanike	7.7%	7.8%	7.3%	7.0%	7.5%
85 Makineri dhe pajisjet elektrike dhe pjesët e tyre	4.5%	4.4%	4.1%	4.1%	5.2%
86 Lokomotivat e trenave, vagonat dhe pjesët e tyre	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
87 Mjetet e transportit të ndryshëm nga vagonat e hekurudhës	12.3%	11.5%	9.9%	7.3%	9.6%
88 Avionët, anijet e hapësirës dhe pjesët e tyre	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
89 Anijet, varkat dhe strukturat lundruese	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
90 Instrumentat dhe aparatet optike, fotogr., kinematogra. etj.	1.0%	1.1%	1.0%	1.0%	1.1%
91 Orët e të gjitha llojeve dhe pjesët e tyre	0.1%	0.1%	0.1%	0.2%	0.1%
92 Instrumentat muzikore pjesët e tyre	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%

93 Armët dhe municion; pjesët dhe aksesorët e tyre	0.2%	0.2%	2.1%	0.3%	0.1%
94 Mobilitetë, krevat, dyshekët, llampat dhe pajisjet e ndriçimit etj	1.8%	1.7%	1.7%	1.7%	1.8%
95 Lodrat dhe pjesët plotësuese të tyre	0.4%	0.4%	0.4%	0.4%	0.4%
96 Artikuj të ndryshëm të prodhuar	0.5%	0.5%	0.6%	0.5%	0.5%
97 Veprat e artit, copat e mbledhura dhe antikat	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
98 Industriale e plotë	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
99 Te tjera	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
<b>Gjithsej</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Bazuar në të dhënat e paraqitura në Tabelën 1. shohim trendin mestare për periudhën 2021–2025. Struktura e importit të Kosovës mbetet e dominuar nga lëndët djegëse, mjetet e transportit dhe makineritë, duke treguar një varësi të lartë nga produktet industriale dhe energjetike, grupet kryesore të Importet janë:

Lëndët djegëse minerale (Kapitulli 27), -ky mbetet grupi kryesor i importit, me një mesatare prej 13.3% gjatë pesë viteve të fundit.


Mjetet e transportit (Kapitulli 87), -ka shënuar rritjen të qëndrueshme, një mesatare prej 10.1% në pesë vitet e fundit, duke kulmuar në 12.3% vetëm në vitin 2025.

Makineritë dhe pajisjet (Kapitujt 84 dhe 85), -së bashku përbëjnë rreth 12% të totalit të importeve (Kap. 84 me 7.5% dhe Kap. 85 me 4.5% mesatarisht).

Produktet ushqimore dhe konsumit, -importet e produkteve ushqimore shfaqin një qëndrueshmëri, por me një trend të lehtë rënës në peshën e tyre totale ndaj importit të përgjithshëm: Mishi (Kap. 02) dhe Pijet (Kap. 22) mbajnë një peshë të qëndrueshme rreth 2% deri në 2.3% në pesë vitet e fundit.

Materialet ndërtimore dhe industriale: Plastika (Kap. 39), përbën një pjesë të rëndësishme me 5.4% mesatarisht, duke treguar përdorim të gjerë në industri dhe paketim. Giza dhe çeliku (Kap. 72), kanë një peshë mesatare prej 5.5%, me një trend rritës krahasuar me dekadën e kaluar. Matrialet industriale si Produktet farmaceutike (Kap. 30), mbajnë një peshë mesatare prej rreth 2.4%, me një rritje të lehtë progresive ndër vite.

Figura 3. Importi 2025, struktura në % sipas kapitujve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK),

Figura 3. paraqet strukturën në përqindje vetëm për vitin 2025, nga kjo shihet se struktura e importit dominohet nga disa kapituj kryesorë që përbëjnë rreth 2/3 të gjithsej importeve sipas kategorive kryesore të mallrave. Vetëm 15 kapituj përbëjnë 65.6% të gjithsej importeve, (apo 4,627.0 mil. Euro nga gjithsej 7,048.3 mil. Euro importe).

Kategoritë kryesore të importit për vitin 2025 janë: Mjetet e transportit (Kapitulli 87), me 12.3% (apo 870.1 mil. Euro); Lëndët djegëse minerale dhe vajrat minerale (Kapitulli 27), me 12.3% (apo 868.8 mil. Euro); Reaktorët nuklearë, makineritë dhe pajisjet (Kapitulli 84), me 7.7% (apo 542.1 mil. Euro); Giza dhe çeliku (Kapitulli 72), me 4.7% (apo 332.9 mil. Euro); Plastika dhe artikujt prej tyre (Kapitulli 39), me 4.6% (apo 327.0 mil. Euro) dhe Makineri dhe pajisjet elektrike dhe pjesët e tyre (Kapitulli 85), me 4.5% (apo 317.8 mil. Euro) nga gjithsej 7,048.3 milionë Euro importe, etj.

### 2.1. Exportit i mallrave sipas kapitujve (analiza krahasimore e trendeve)

Të dhënat në vazhdim paraqesin strukturën e eksporteve të Kosovës, duke zbërthyer pjesëmarrjen në përqindje të secilit kapitull tregtar sipas viteve. Përmes Tabelës 2. analizohet ecuria vjetore e grupmallërave kryesore të exportuara për periudhën 2021–2025.

Këto të dhëna nxjerrin në pah mundësitë e ekonomisë vendore dhe shërben si bazë për të identifikuar sektorët me potencial për zëvendësimin e importit, rritjen e eksportit dhe rritjen e prodhimit të brendshëm.

Tabela 2. Exporti sipas Kapitujve (01 deri 99), strukturuar në % sipas viteve 2021 deri 2025

Importi sipas Kapitujve, struktura në %	2025	2024	2023	2022	2021
01 Kafshë të gjalla	0.3%	0.8%	0.4%	0.1%	0.0%
02 Mish dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit	1.0%	0.7%	1.0%	0.8%	0.1%
03 Peshku dhe kafshët guackore të nënujshme	0.1%	0.0%	0.1%	0.1%	0.0%
04 Produkte bulmetore, vezët, mjalti	0.3%	0.3%	0.3%	0.2%	0.2%
05 Produkte me origjinë kafshore të papërfshira diku tjetër	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
06 Pemët dhe bimët, rrënjët, lulet dhe gjethet zbukuruese	0.0%	0.0%	0.1%	0.2%	0.2%
07 Zarzavatet e ngrënshme dhe rrënjët e tuberat përkatëse	1.5%	1.4%	1.3%	1.0%	0.9%
08 Frutat dhe arrat e ngrënshme	1.7%	1.0%	0.6%	0.9%	1.5%
09 Kafe, çaj dhe erëza	1.2%	1.0%	1.1%	0.7%	0.8%
10 Drithërat	0.1%	0.0%	0.0%	0.0%	0.1%
11 Produkte të industrisë bluajtëse, mjalti, niseshte	0.2%	0.2%	0.2%	0.1%	0.2%
12 Farat vajore, bimët industriale apo medicinale, ushqim për kafshët	0.5%	0.5%	0.5%	0.4%	0.5%
13 Rreshrat dhe lëngje e ekstrakte të tjera vegjetale	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
14 Materiale vegjetale që përdoren përthurje	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
15 Vajra dhe dhjamra kafshore apo vegjetale	0.4%	0.8%	0.9%	0.5%	0.2%
16 Ushqimet e përgatitura prej mishi, peshku, molusqe, etj.	0.6%	0.4%	0.7%	0.8%	0.5%
17 Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij	0.2%	0.2%	0.2%	0.1%	0.1%
18 Kakao dhe përgatitje kakao	0.5%	0.3%	0.4%	0.3%	0.3%
19 Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit	1.1%	0.8%	0.6%	0.3%	0.3%
20 Përgatitjet prej zarzavateve, frutave, arrave, etj.	1.8%	1.5%	1.6%	1.1%	1.2%
21 Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	0.6%	0.6%	0.4%	0.2%	0.2%
22 Pijet, alkoolet dhe uthullat	7.4%	7.2%	6.2%	3.9%	4.9%
23 Mbetjet dhe kthimet nga industria ushqimore	0.2%	0.3%	0.2%	0.2%	0.2%
24 Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
25 Kripërat, sulfuret, oksidet, gëlqere dhe çimento	0.4%	0.2%	0.1%	0.2%	0.2%
26 Xeherorët, zgjyrat dhe hiri	2.4%	1.6%	2.1%	2.8%	3.5%
27 Lëndët djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet e distilimit të tyre	6.4%	7.0%	5.0%	15.1%	2.1%
28 Kimikatet inorganike, përbërjet organike	0.0%	0.0%	0.1%	0.0%	0.1%
29 Kimikatet organike	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
30 Produktet farmaceutike	0.2%	0.2%	0.2%	0.1%	0.1%
31 Plehëruesit	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.1%
32 Ekstraktet ngjyrosëse dhe tanike, stukot dhe mastiçet, bojrat	1.1%	1.0%	0.9%	0.7%	0.8%
33 Vajrat thelbësore dhe rrëshirat, përg. e parfu., kozmetikës, tualetit	0.2%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
34 Sapuni, preparatet parëse, lubrikues, qirinjtë	1.7%	1.7%	1.4%	1.0%	1.0%
35 Substancat albuminoidale, enzimat	0.1%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
36 Eksplozivët, produktet piroteknike, shkrepset	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
37 Mallrat fotografike dhe kinematografike	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
38 Produkte të ndryshme kimike	0.2%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
39 Plastika dhe artikuj prej tyre	12.3%	12.4%	13.2%	12.3%	10.2%
40 Gomë dhe artikuj të tij	0.4%	0.3%	0.5%	0.6%	0.4%
41 Lëkurët e papërpunuara dhe të përpunuara	0.4%	0.5%	0.6%	0.9%	1.0%

42 Artikuj prej lëkure	0.2%	0.2%	0.2%	0.1%	0.0%
43 Gëzofët dhe qimet artificiale	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
44 Druri dhe artikuj prej druri, qymyri i drurit	2.1%	1.8%	1.6%	1.6%	1.4%
45 Tapa dhe artikuj prej tape	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
46 Prodhimet e kashtës, punimet në xunkth e në kallama	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
47 Brumi i drurit apo i materialeve të tjera fibroze celulozike	0.4%	0.4%	0.4%	0.4%	0.4%
48 Letra dhe kartoni, artikuj të brumit të letrës dhe të kartonit	0.8%	1.0%	0.9%	0.7%	0.5%
49 Librat, revistat, pikturat dorëshkrimet, shtypshkrimet dhe projektet	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
50 Mëndafsh	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
51 Leshi, qime kafshësh të holla	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.1%
52 Pambuku	0.0%	0.1%	0.0%	0.0%	0.0%
53 Fibra të tjera tekstile vegjetale	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
54 Filamentet e bëra nga njerëzit	0.7%	0.3%	0.1%	0.0%	0.0%
55 Fibrat themelore të bëra nga njerëzit	0.0%	0.1%	0.1%	0.1%	0.0%
56 Mbushjet shajak dhe pëlhura të paendura	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
57 Qilimet dhe veshje të tjera të dyshemesë prej tekstili	0.2%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
58 Pëlhurat speciale të endura, tantella, tapiceri, qëndisimat	0.0%	0.1%	0.0%	0.0%	0.0%
59 Pëlhura tekstile të ngopura, të veshura, të mbul. apo të laminu.	0.2%	0.2%	0.3%	0.3%	0.4%
60 Pëlhura të thurura me një fije apo me shumë fije	0.2%	0.2%	0.0%	0.0%	0.0%
61 Artikuj të veshjes dhe rroba plotësuese, të thurura	0.8%	0.9%	0.9%	0.4%	0.2%
62 Artikuj të veshjes dhe plotësues të veshjes jo të thurura	3.1%	2.7%	2.3%	1.5%	1.2%
63 Artikuj të tjerë tekstile të ndërt., veshjet e përd., lecka mbetu.	1.3%	1.4%	0.8%	0.7%	1.4%
64 Veshjet e këmbëve	0.3%	0.4%	0.5%	0.3%	0.4%
65 Veshjet e kokës	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
66 Çadrat e diellit, bastunet etj.	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
67 Puplat dhe pushi i përgatitur, lulet artificiale	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
68 Artikuj prej guri, allçie, çimento, mike, asbesti etj	1.4%	1.2%	1.1%	1.0%	1.1%
69 Produkte qeramike	0.6%	0.6%	0.8%	0.6%	0.4%
70 Qelqi dhe artikuj prej qelqi	2.1%	2.2%	1.7%	1.5%	1.0%
71 Perlat natyrale, gurët e çmuar, bizhuteritë, monedhat	0.6%	1.5%	1.7%	0.9%	0.5%
72 Giza dhe çeliku	2.9%	4.7%	4.3%	5.1%	15.7%
73 Artikuj prej gize dhe çeliku	10.7%	10.7%	10.8%	9.2%	9.0%
74 Bakri dhe artikuj prej bakri	1.9%	1.5%	1.3%	1.6%	2.2%
75 Nikeli dhe artikuj prej tij	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
76 Alumini dhe artikuj prej tij	5.1%	5.7%	4.3%	4.1%	4.1%
78 Plumbi dhe artikuj prej tij	0.2%	0.2%	0.4%	0.5%	0.4%
79 Zinku dhe artikuj prej tij	0.4%	0.4%	0.4%	0.3%	0.4%
80 Kallaji dhe artikuj prej tij	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
81 Metale të tjera bazë	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
82 Veglat e punës, pajisjet e punës, takëmet e ngrënies etj	0.1%	0.1%	0.2%	0.2%	0.3%
83 Artikuj të ndryshëm prej metali bazë	0.4%	0.4%	0.3%	0.2%	0.2%
84 Reaktorët nuklearë, bolierët, makineritë e pajisjet mekanike	2.6%	2.5%	2.0%	1.6%	2.3%
85 Makineri dhe pajisjet elektrike dhe pjesët e tyre	3.4%	2.3%	2.0%	1.5%	1.8%

86 Lokomotivat e trenave, vagonat dhe pjesët e tyre	0.1%	0.1%	0.0%	0.0%	0.0%
87 Mjetet e transportit të ndryshëm nga vagonat e hekurudhës	1.2%	1.2%	1.3%	1.1%	1.0%
88 Avionët, anijet e hapësirës dhe pjesët e tyre	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
89 Anijet, varkat dhe strukturat lundruese	0.1%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
90 Instrumentat dhe aparatet optike, fotogr., kinematogra. etj.	0.1%	0.2%	0.1%	0.1%	0.1%
91 Orët e të gjitha llojeve dhe pjesët e tyre	0.1%	0.1%	0.2%	0.2%	0.1%
92 Instrumentat muzikore pjesët e tyre	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
93 Armët dhe municion; pjesët dhe aksesorët e tyre	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
94 Mobilitetë, krevatë, dyshekët, llampat dhe pajisjet e ndriçimit etj	9.8%	10.6%	17.2%	17.9%	20.6%
95 Lodrat dhe pjesët plotësuese të tyre	0.1%	0.1%	0.0%	0.0%	0.0%
96 Artikuj të ndryshëm të prodhuar	0.3%	0.3%	0.2%	0.1%	0.1%
97 Veprat e artit, copat e mbledhura dhe antikat	0.0%	0.1%	0.0%	0.0%	0.0%
98 Industriale e plotë	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
99 Te tjera	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
<b>Gjithsej</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Bazuar në të dhënat e periudhës 2021–2025, eksportet e Kosovës dominohen nga disa kategori kryesore mallrash, ku peshën më të madhe e mbajnë produktet e plastikës, artikujt e metaleve, mobilitetë e artikujt e drurit, pijet dhe produktet ushqimore të përpunuara. Grupet kryesore që dominojnë strukturën e eksporteve janë:

Plastika dhe artikujt prej saj (Kapitulli 39), -kjo kategori është një nga shtyllat më të fuqishme të eksportit, duke përbërë rreth 12.3% të totalit në vitin 2025. Pjesëmarrja e saj ka qenë e qëndrueshme, me një mesatare prej 12.1% për të gjithë periudhën 5-vjeçare (2021–2025).

Artikujt prej gize dhe çeliku (Kapitulli 73), -kjo kategori zë një vend të rëndësishëm me 10.7% të eksporteve në vitin 2025. Ajo ka shënuar një rritje graduale nga viti 2021, ku mernte pjesë me 9.0% të gjithsej eksporteve.


Mobilitetë, krevatët dhe dyshekët (Kapitulli 94), -megjithëse ka pasur një rënie të ndjeshme në vitet e fundit (nga 20.6% në vitin 2021 në 9.8% në vitin 2025), kjo kategori mbetet ndër më kryesoret. Ajo mban mesataren më të lartë 5-vjeçare të eksporteve me 15.2%.

Pijet, alkoolet dhe uthullat (Kapitulli 22), -ky sektor ka shënuar rritje të vazhdueshme, duke arritur në 7.4% të eksporteve totale në vitin 2025, krahasuar me 4.9% që ishte në vitin 2021.

Lëndët djegëse minerale dhe vajrat minerale (Kapitulli 27), - te kjo kategori vrehen luhatje të mëdha, duke arritur kulmin në vitin 2022 me 15.1%, ndërsa në vitin 2025 zë rreth 6.4% të eksporteve.

Alumini dhe artikujt prej tij (Kapitulli 76), - edhe ky sektor është me peshë dhe përfaqëson rreth 5.1% të eksporteve në vitin 2025.

Figura 4. Exporti 2025, struktura në % sipas kapitujve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK),

Nga Figura 4 shihet se eksportet janë më të përqendruara, te 15 kapitujt të cilet përbëjnë rreth  $\frac{3}{4}$  të gjithesj eksporteve, sipas kategorive kryesore të mallrave, këta kapituj marrin pjesë me 73.8% te gjithesj eksporteve, (apo 695.5 mil. Euro nga gjithesj 942.1 mil. Euro eksporte në vitin 2025).

Eksportet sipas kategorive kryesore të mallrave janë më të përqendruara te: Plastika dhe artikujt prej tyre (Kapitulli 39), me 12.3% (apo 115.8 mil. Euro); Artikujt prej gize dhe çeliku (Kapitulli 73), me 10.7% (apo 100.8 mil. Euro); Mobileritë, shtretërit dhe llampat (Kapitulli 94), me 9.8% (apo 92.5 mil. Euro); Pijet, alkoolet dhe uthullat (Kapitulli 22), me 7.4% (apo 69.6 mil. Euro); Lëndët djegëse minerale dhe produktet e tyre (Kapitulli 27), me 6.4%, (apo 59.9 mil. Euro) dhe Alumini dhe artikuj prej tij (Kapitulli 76), me 5.1% (apo 47.8 mil. Euro), nga gjithesj 942.1 milionë Euro eksporte, etj.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në Tabelën 1 dhe 2, strukturën dhe trendin e importeve - eksporteve nëpër vite, duke pasur parasysh resurset e vendore, janë disa sektorë ku Kosova mund të zëvendësojë një pjesë te importit me prodhimet e veta ose të rrisë eksportin.

Për të arritur këtë duhet orientohemi në ato fusha ku vendi ka disa përparësi krahasuese në raport me partnerët kryesorë nga importojm, e që mund të shfrytëzohen për të zëvendësuar importet dhe rritur eksportet si:

Energjia dhe Lëndët djegëse (Kapitulli 27),

- Importi i Lëndëve djegëse mbetet kategoria më e madhe (12.3% në 2025), Kosova ka rezerva masive të linjtit dhe potencial për energji të ripërtëritshme (diell dhe erë).

Investimi në kapacitete të reja energjetike dhe eficiencë mund të reduktonte varësinë nga importi i energjisë elektrike (që shpesh faturohet në këtë kategori) dhe të nxiste industrializimin.

#### Industria e Plastikës dhe Përpunimit (Kapitulli 39),

- Plastika përbën një pjesë të lartë të importit (5.4% mesatarisht), Kosova ka një fuqi punëtore të re, e gatshme dhe një sektor ekzistues të plastikës që është mjaft konkurrues me eksporte në rritje të vazhdueshëm drejt vendeve të BE-së. Kjo paraqet një mundësi të mirë për zëvendësimi i produkteve të plastikës për paketim dhe ndërtim me prodhim vendor mund të uli ndjeshëm deficitin, duke shfrytëzuar koston më të ulët të punës.

#### Bujqësia dhe Industria ushqimore (Kapitujt 01-24),

- Rregullisht importohen sasi të mëdha të mishit, drithërave dhe pijeve, por njëkohësisht Kosova eksporton zarzavate (1.5% në 2025) dhe fruta (1.7% në 2025). Te exportet ekziston hapësirë e madhe për të rritur prodhimin e brendshëm për të mbuluar nevojat e tregut që aktualisht plotësohen nga importi. Kosova ka kokë bujqësore pjellore dhe një traditë në blegtori e pentari. Investimi dhe përmirësimi i fermave vendore mund të zëvendësojë importin e mishit (Kap. 02) dhe bylmetit (Kap. 04) gjithashtu investimi dhe mbeshtja në përpunimi i frutave/perimeve në vend që të importohen ushqime të përgatitura (Kap. 19-21), Kosova mund të shfrytëzojë produktet e saj primare për t'i paketuar e shitur brenda dhe jashtë vendit. Sektori i pijeve dhe alkooleve (7.4% e eksporteve) po tregon rritje dhe mund të shërbejë si model për prodhimin vendas.

#### Metalet dhe Materialet e Ndërtimit (Kapitujt 72-73),

- Giza, çeliku dhe artikujt prej tyre përbëjnë mbi 7% të importeve, te shqyrtohet mundësit për shfrytëzimin e pasuri minerale (si plumb, zink, ferronikel etj), përmes rinjvitalizimi i industrisë minerare dhe përpunuese aty ku ka mundësi (si Trepça apo Ferronikeli) do të mundësonte që Kosova të prodhojë disa lëndë të parë për ndërtimin, duke ulur nevojën për import të metaleve bazë.

#### Mobilieri dhe Përpunimi i Drurit (Kapitulli 94),

- Edhe pse importi i mobilieve mbetet ende i lartë (1.8% apo rreth 130 mil. Euro në 2025), megjithatë ky sektor mbetet një shtyllë e rëndësishme në eksporte me një pjesë marrje prej 9.8% apo mbi 92.5 mil. Euro nga gjithsej exportet në 2025, duke treguar kapacitete që mund të shfrytëzohen edhe më tej për të zëvendësuar produktet e importuara të kësaj kategorie. Kosova ka sipërfaqe pyjore dhe mjeshtëri tradicionale në përpunim e drurit. Sektori i drurit në Kosovë tashmë ka treguar sukses në eksport dhe me një mbështetje më të madhe, ky sektor mund të mbulojë plotësisht kërkesën vendore dhe të kthehet në një shtyllë kryesore të eksportit. Industria e Drurit-sektori i mobilieve (Kap. 94) ka treguar qëndrueshmëri, me eksporte në rritje drejt Gjermanisë dhe Zvicrës.

#### Sektori i Shërbimeve (ICT & BPO),

- Kosova ka një bilanc tregtar jashtëzakonisht pozitiv në shërbime, përparësia kryesore këtu është kapitali njerëzor i ri, njohja e gjuhëve të huaja dhe kostot konkurruese të punës.

Për të mbështetur këtë transformim ekonomik dhe për të rritur konkurrueshmërinë e Kosovës kundrejt vendeve nga importohet, institucionet e vendit duhet të ndërmarrin veprime dhe masa mbështetëse për të krijuar:

- Nxitja e investimeve në teknologji përpunuese, -të krijohen pako stimuluese për bizneset që investojnë në linja prodhimi që përpunojnë lëndën e parë vendase (bujqësore dhe minerale), me qëllim krijimin e produkteve finale për tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm. Te krijohen kushte për një infrastrukturë moderne për investorët (si parqeve industriale, teknologjike). Te krijoj(zgjeroi) skema të garantimit të kredisë specifikisht për sektorin e prodhimit dhe eksportit, duke ulur rrezikun dhe normat e interesit për investime kapitale.
- Zhvillimi i kapitalit njerëzor, -të investohet në trajnimin dhe edukimin e kapitalit njerëzor të ri, duke e përshtatur atë me nevojat e sektorëve prodhues dhe përpunues për të rritur efikasitetin dhe konkurrueshmërinë.
- Politika për përmirësimin e bilancit tregtar, -duke qenë se importet arritën në mbi 7 miliardë Euro në vitin 2025, institucionet duhet të aplikojnë masa që favorizojnë prodhuesit vendor, të lehtësojnë procedurat e eksportit, te krijoj(zgjeroi) skema për stimulimin e prodhimit primar dhe mbështetjen e bizneseve agro-përpunuese.
- Mbështetja e ndërmarrjeve eksportuese, -të ofrohen subvencione ose lehtësime tatimore për sektorët që kanë treguar rritje dhe qëndrueshmëri (si plastika, metalet dhe pijet) për të forcuar praninë e tyre në tregjet ndërkombëtare, kushte për mbështetje financiare për prodhuesit vendorë që të pajisen me certifikata të BE-së (ISO, Global GAP) 2, duke u mundësuar hyrjen në tregjet ndërkombëtare pa barriera teknike.

Ky orientim strategjik do të mundësonte që Kosova të reduktonte varësinë nga importi, duke zëvendësuar një pjesë e importit me prodhimet e veta ose do të rrisë eksportin dhe të përmirësonte ndjeshëm deficitin tregtar. Kosova gradualisht do të kalonte nga një ekonomi konsumi në një ekonomi që përpunon resurset e veta (bujqësore dhe minerale) duke përdorur kapitalin njerëzor të ri.

---

Përgatitur nga: Oda Ekonomike e Kosovës

Email: [info@oek-kcc.org](mailto:info@oek-kcc.org)

Web: [www.oek-kcc.org](http://www.oek-kcc.org)

---

<sup>2</sup> Zbatimi i standardeve ndërkombëtare si **ISO** (ISO 9001: Menaxhimi i cilësisë; ISO 22000: Siguria ushqimore; ISO 14001: Menaxhimi mjedisor) dhe **Global GAP** (për praktikatat e mira bujqësore) është bërë i domosdoshëm për bizneset kosovare që synojnë tregjet evropiane.